



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVETKOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KOMISIONI DISIPLINOR//DISCIPLINSKA KOMISIJA/ THE DISCIPLINARY COMMITTEE

KD.nr.04/2018

KOMISIONI DISIPLINOR, në përbërje nga gjyqtarët: Nenad Lazic, kryetar, Manushe Karaqi dhe Skender Çoçaj, anëtar të Komisionit, duke e shqyrtuar çështjen e përgjegjësisë disiplinore ndaj XXXXX XXXXXXXX, gjyqtar në Gjykatën Themelore në XXXXX, sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor ZPD-2018-122, i njëjti në procedurë te Komisioni Disiplinor ka marrë numrin KGJK/KD/02/2018, për pretendimin për sjellje të pahijshme të përcaktuar sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223) dhe shkelje e Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtar, në seancën dëgjimore të mbajtur në prezencën e përfaqësueses së ZPD-së, znj.Hasime Osmani dhe gjyqtarit XXXXX XXXXXXXX me datë 21.12.2018 merr këtë:

V E N D I M

XXXXx XXXXXXXX, gjyqtar në Gjykatën Themelore në XXXXx, **nuk** është përgjegjëse për sjellje të pahijshme të përcaktuara sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.4 shkelje e kodeve të zbatueshëm të etikës të përcaktuara sipas Ligjit për Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223), siç është pretenduar në raportin përfundimtar të Zyrës se Prokurorit Disiplinor ZPD-2018-122.

A r s y e t i m

Në Komisionin Disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovë Zyra e Prokurorit Disiplinor ka paraqitur Raportin Përfundimtar ZPD-2018-122 se bashku me shkresat e lëndës, më të cilin e ka ngarkuar XXXXx XXXXXXXX, gjyqtar në Gjykatën Themelore në XXXx për sjellje të pahijshme të përcaktuara sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.4-shkelje e kodit të zbatueshëm të etikës të përcaktuara sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovë.

Hetimin disiplinor Zyra e ka filluar në bazë të parashtrësës së paraqitur nga zyrtaret policor qe kanë qenë në detyrë me 09 maj 2018 (rreth orës 13:00) në pikën e kalimit Kufitar Dheu i Bardh, te cilën kanë theksuar se Gjykatësi XXXXx XXXXXXXX duke kaluar kufirin shtetëror Serbi Kosovë, me automjetin e tij Shkoda 06-700-CK nuk i është përmbajtur procedurave të kontrollit kufitar. Sipas parashtruesi fillimisht gjyqtari ka refuzuar paraqitjen e dokumenteve të nevojshme për kalim të kufirit shtetëror të kërkuar nga zyrtari policor qe ka qenë në detyrë dhe pastaj e ka ofenduar zyrtarin policor në mënyrë të përsëritur. Sipas pretendimeve të parashtruesit të parashtrësës XXXXX XXXXXXXX kishte kërkuar qe të mos i nënshtrohet kontrollit kufitar pasi qe është e ditur qe ai punon si gjyqtar.

Për me tepër është pretenduar se XXXXX XXXXXXXX frekuenton shpesh pik kalimin kufitar Dheu i Bardh dhe ka ndodhur qe te mos lejohet të hyjë në Kosovë pasi qe në bagazhin e veturës së tij ka transportuar gjashtë (6) arka me nga njëzetekatër (24) shishe birra dhe është kërkuar që ta kthej mallin komercial mbrapa.

Në seancën dëgjimore të Komisionit disiplinor të mbajtur me datë 21.12.2018 përfutjesja e Zyrës së Prokurorit Disiplinor deklaroi se gjatë zhvillimit të hetimit gjyqtari XXXXX XXXXXXXX nuk është paraqit për të dhënë deklaratën apo për të kundërshtuar pohimet e zyrtareve policor. Në një situatë të tillë Zyra ka përfunduar raportin bazuar vetën në pretendimet e 5 zyrtareve policor. Disa herë Zyra ka tentuar të komunikojmë me gjyqtarin i cili edhe pse nuk ka kundërshtuar nuk është paraqitur në zyre.

Në bazë të deklaratave Zyra kishte zhvilluar edhe një çështje tjetër të cilën e ka potencuar në këtë raport lidhur me eksportimin e mallrave të ndaluara. Pasi kanë komunikuar me zyrtarin, i cili ka deklaruar se e kanë ndaluar lidhur me transportin e birrave, nuk kanë mundur me gjete prova të tjera, për me mujt me i vazhduar hetimet. Kanë pasur vetëm një deklaratë dhe nuk kanë treguar as datën kur ka ndodhur dhe për këtë arsyeje Zyra hetime nuk kemi mundur me i zhvilluar lidhur me këtë çështje.

Por, për sjellje të pahijshme, për fjalosjen me zyrtaret policor, Zyra është bazuar vetëm në deklaratat e zyrtareve policor, dhe në bazë të këtyre deklaratave mendon se gjyqtari ka bërë sjellje të pahijshme dhe i ka rekomanduar Komisionit inicimin e procedurës disiplinore.

Gjyqtari XXXXX XXXXXXXX, në seancën dëgjimore të Komisionit Disiplinor ka deklaruar se i vjen shume keq qe ndodhet para kolegeve për pretendime disiplinore. E ka kundërshtuar në tërësi raportin përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor. Sipas gjyqtarit XXXXXXXX nuk qëndron pretendimi ZPD se ngjarja ka ndodhur me 9 maj 2018, por ka ndodhur me datë 6 maj 2016 rretho orës 6:00 deri 6:30 të mëngjesit dhe ka qenë ditë e diel. Sipas gjyqtari nuk qëndron pretendimi i zyrtareve policor se ai nuk i ka dorëzuar dokumentet e identifikimit, është fakt notor se asnjë nuk mund ta kaloj kufirin pa i dorëzuar dokumentet e identifikimit. Sipas gjyqtari i gjithë problemi qëndron te zyrtari policor Arben Dermaku, i cili edhe e kishte iniciuar parashtrësën në ZPD. Sipas gjyqtarit XXXXXXXX gjatë kohës sa ai ka qenë gjyqtar në Kamenicë, e kishte dënuar disa herë, ndërsa rreshterin Feriz Bunjaku i cili është njeri ndër këta 5 zyrtar policor qe kanë hartuar parashtrësën kundër gjyqtarit XXXXX, e kishte dënuar me 15 deri 20 me dënim për vjedhje pylli, është ordiner për vjedhje pylli, ka deklaruar gjyqtari në seancë.

Në këtë ditë kritike sipas gjyqtarit ka qenë pike kalimi Kosovë Serbi dhe jo siç shkruan në raportin e ZPD-së Serbi Kosovë. Sipas XXXXX XXXXXXXX ai ka dhënë dokumentacionin dhe për këtë ka dëshmitar të gjallë, njeri nder ta ka qenë i ftuar qe te vijë në seancën e komisionin por ka vdekur, dhe ai ka qenë Njazi Sermagja. Pasi ja ka dhanë dokumentacionin ka pritur 20 minuta, pas kësaj ja kanë lypur lejen qarkullimit, të gjitha këto janë në sistem me të cilat vërtetohen se a e ka

dhanë dokumentacionin apo jo. Pas kësaj gjithë sipas deklaratës së gjyqtarit, ai ka pritur edh 10 minuta, dhe mandej ka trokitur ne dritaren e vendit të policisë duke e pyetur se pse po ndodh gjithë kjo vonës. Policia sipas gjyqtarit i është përgjigjur duke i thënë se është punë e jona dhe se ty nuk ta ka bërë vendin e punës si gjyqtar nëna. E gjithë rrjedha e situatës ka qenë kjo, sipas deklaratës se gjyqtarit Xxxxx.

Sa i përket mos deklarimit sipas ftesës se ZPD-së, sipas gjyqtari ai ka qenë në zyrat e ZPD-së mirëpo nuk e kishte gjetur inspektoren e rastit konkret dhe se nuk ka ditur qe inspektorja ka qenë me gjysmë orari në punë. Mundësi të tjera nuk ka pas për me shkua, për shkak të ngarkesës me lëndë dhe seancave të caktuara.

Sipas gjyqtarit Xxxxxx ai këtë rast ka dashur ta paraqes në inspektoratin e policisë, mirëpo e kishte lutur polici Njazi Sermaxhaj, komandant në pikën e Dheut të Bardh qe mos ti raportoj, dhe ai ja kishte dhënë besën se nuk do ti paraqes.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i ZPD-së deklaroi se në bazë të kodit të etikës dhe sjelljes profesionale për gjyqtar pika 4 të integritetit thotë: gjyqtari sillet në mënyrë të ndershme dhe të dinjitetshme dhe duhet të jetë gjatë gjithë kohës në harmoni me karakterin e lart moral i cili është thelbësor për ruajtjen e reputacionit gjyqësor, gjyqtari sillet me integritet si në jetën personale dhe profesionale dhe nuk duhet të përdor gjuhen e urrejtjes apo të keq sjelljes së pahijshme dhe të vrazhdë. Në këtë rast sipas ZPD-së gjyqtari e ka shkel kodin e etikes andaj edhe rekomandon qe ndaj gjyqtarit XXXXx XXXXXXXX të shqiptohet sanksioni disiplinor në mbështetje te sjelljes së pahijshme te vërtetuar.

Ndërsa XXXXX XXXXXXXX në fjalën përfundimtare deklaroi se në tersi e kundërshton propozimin e bërë nga ZPD, sepse nuk përputhet koha dhe vendi.Me përgjegjësi morale dhe penale deklaroi se data e ndodhjes ka qenë 6 maj 2018, ora prej 6:10 deri 6:30.Nga viti 2002 sipas gjyqtarit Xxxxx ai nuk flet me këtë person, (policin Arben Dermaku) dhe se muajt e fundit sa herë e kalon piken kufitare i njëjti ka filluar ta maltretojë, se bashku edhe me tre zyrtaret policor të tjerë. Ka qenë edhe mëshira ime se pse nuk i kam paraqitur në inspektoratin policor. Po ashtu të njëjtit policë ja kanë arritur qëllimit dhe e kanë zhduk incizimin qe është për 2 ore e 10 minuta. Po të kërkohet nga ju Komisioni i nderuar, nuk mund ta gjeni, sepse e kanë zhdukur.

Komisioni Disiplinor i administroj të gjitha provave në shkresat e lëndës, ka dëgjuar edhe deklarata e gjyqtarit të dhënë gjatë seancës dëgjimore, dhe pasi i ka shqyrtuar dhe analizuar konstatoj se gjyqtari XXXXx XXXXXXXX nuk është përgjegjës për sjellje të pahijshme të pretenduara në raportin përfundimtar të ZPD-së.

Sipas vlerësimit të Komisionit nuk qëndrojnë pretendimet e Zyrës se gjyqtari nuk ka pranuar të paraqes dokumentet e identifikimit në piken kufitare të Dheut të Bardh Kosovë Serbi. I njëjti sipas deklaratave të gjyqtarit, qe për Komisionin janë të besuara, i ka prezantuar të gjitha

dokumentet e kërkuar nga policet të pikës kufitare Dheu i Badh Kosovë Serbi. Sipas Komisioni ZPD nuk ka prezantuar prova për pretendime për sjellje të pahijshme të XXXXX XXXXXXXX, për fjalosje verbale, përveç deklaratës së policeve, e qe për Komisionin nuk janë bindëse. Protagonist të situatës se krijuar me datë 6 maj 2018 sipas vlerësimeve të komisionit, janë policet e pikës kufitare Dheu i Bardh të cilët pa arsyeje e kanë vonuar dhe provokuar gjyqtarin gjatë kontrollit të dokumenteve.

Duke patuar parasysh të gjitha këto, Komisioni vlerëson se në këtë rast gjyqtari XXXXX XXXXXXXX nuk ka kryer sjellje të pahijshme siç pretendon ZPD dhe nuk është involvuar me ndonjë veprim konkret qe do të rezultonte me shkelje të standardeve të sjelljeve profesionale për gjyqtarë.

Prandaj, nga këtu dhe nga arsyet e sipër theksuara, Komisioni ka konstatuar se XXXXX XXXXXXXX **nuk** është përgjegjëse për sjellje të pahijshme të parapara me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1, pika 1.4 të ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe nuk ka shkelur standardet e Kodit e Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtar. Në seancën për këshillim dhe votim, njëzëri vendosi qe XXXXX XXXXXXXX, gjyqtar në Gjykatën Themelore në XXXXXX të lirohet nga përgjegjësia disiplinore, prandaj vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR
KD.nr.04/2017, datë 21.12.2018

Kryetar i Komisionit Disiplinor
Gjyqtari, Nenad Lazic

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në Prishtinë, brenda 15- ditësh nga dita e pranimt të Vendimit.

Vendimi t'u dërgohet:

- Nehat Idrizi, kryesues i KGJK-ës;
- Arianit Salihu, u.d drejtor, Zyra e Prokurorit Disiplinor;
- XXXX XXXX, kryetar në Gjykatën Themelore në XXXXXXX;
- XXXXX XXXXXXXX, gjyqtar në Gjykatën Themelore në XXXXX;
- Departamentit të Administratës dhe Personelit në SKGJK;

